ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E GJILANIT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit 651-24-7508-1-1-1

Nr i brendshëm Gl 651 24 045 111

Sa i përket tenderit për **"Furnizim me dru dhe pelet"**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"BERVENIKU CORPORATION" SH.P.K

PRISHTINE

PRISHTINE *10000*

046 950 950

Gëzime Murtezi

bervenikushpk@gmail.com

09/09/2024

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 30.07.2024 Ky aktivitet është në proces të tenderimit dhe afati i fundit për dorëzimin e tendereve është 30.08.2024.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Ky aktivitet i prokurimit eshte ne proces.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK KOMUNA E GJILANIT në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet" nuk e ka respektuar Ligjin për Prokurimi Publik dhe Rregulloren për Prokurim Publik në nenet në vijim :

- **Neni 1 Qëllimi;**
- **Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;**
- **Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;**
- **Neni 17 Dosja e Tenderit; dhe**
- **Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes**
- **Neni 61 Pezullimi i aktivitetit të prokurimit**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kronologjia e aktivitetit të prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet"

Data e njoftimit për kontratë është 30.07.2024, ndërsa afati i fundit për dorëzimin e tendereve është 30.08.2024.

Bazuar në Ligjin për Prokurim Publik dhe legjislacionin sekondar, "Berveniku Corporation" SH.P.K me datë 12/08/2024 ka bërë kërkesë për informacione sqaruese për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet" dhe nuk nukk kemi marr përgjigje nga Ak.

AK është i obliguar që të shqyrtoj menjëherë kërkesën për informacione sqaruese dhe të konstatoj nëse informata shtesë ose sqarimi i kërkuar është i nevojshëm apo jo. Ne kemi pranuar një email me datë 15/08/2024, në të cilin thuhet, citim
"Te nderuar

Lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me dru dhe pelet" , lidhur me sqarimin reth Dosjes se Tenderit nga ana juaj , ju njoftojm qe ne afat sa me shkurt ju pergjigjemi pytjeve

Ju faleminderit per mirkuptim

Me respekt!
Departamenti i prokurimit
Komuna e Gjilanit”

Mirëpo akoma nuk kemi marr përgjigje në sqarimet e kërkuara.

OE “BERVENIKU CORPORATION” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rsishqyrtim me datë 19.08.2024. AK nuk e ka pezulluar fare aktivitetin e prokurimit, sic parashihet me nenin 61.1 të RRPP 001/2022. Pra AK e ka shkelur neni 61 “Pezullimi i aktivitetit të prokurimit”, paragrafi 1, i cili thotë “parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe në ketë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet të njoftoj me shkrim të gjitha palët lidhur me pezullimin e procedurës se prokurimit në fjale”.

AK e ka shkelur edhe paragrafin 3, të nenit 61 “Pezullimi i aktivitetit të prokurimit”, i cili kërkon që Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë”, sepse përgjigja në kërkesën për rishqyrtim është dhënë me datë 30.08.2024.

Pra, AK e ka tejkaluar afatin e përcaktuar kohorë për përgjigje në kërkesën për rishqyrtim, duke na e kthyer përgjigjen ditën e dhjetë (10) nga dita e pranimitë të kërkesës për riahqyrtim

Vlenë të ritheksohet se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit që në këtë kërkesë për rishqyrtimi, përvec shkeljeve ligjore gjatë vendosjes së kritereve të përzgjedhjes, ka bërë shkelje edhe në trajtimin dhe zbatimin e afateve për përgjigje në kërkesën për rishqyrtim.

Zyra e Prokurimit në K.Gjilan ka përcaktuar në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru dhe pelet” ka përcaktuar kritere të përzgjedhjes që nuk janë proporcionale me lëndën e kontratës dhe të cilat bien ndesh me parimin e konkurrencës, qëllimin e prokurimit dhe shfrytezimin ekonomik, efikas dhe efektiv të parasë publike.

Pra, AK në Dosje të Tenderit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru dhe pelet” ka përcaktuar kritere subjektive dhe diskriminuese, të cilat do ta dëmtojnë konkurrencën dhe do të favorizojnë një OE.

Kërkesat e përcaktuara në vijim nuk janë relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës:

Kërkesa 2 Lot 1-Operatori Ekonomik duhet ti ofroj dëshmi bindëse Autoritetit Kontraktues që nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore ne Agjencinë Pyjore te Kosovës dhe se nuk ka obligime të pakryera ndaj Agjencionit nga kontratat e mëhershme

Kërkesa 2 ka të bëjë më një vërtrtim që Agjencinë Pyjore te Kosovës ka marr vendim më datë 15/08/2020 që nuk do të lëshojë më vërtetime të tilla.

Kërkesa 3 Lot 1 -Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës për prerje dhe transport të drunjëve për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore. Dëshmia 3. Kopje e Licencës (e vlefshme)

Kërkesa 3 për Lot 1 është diskriminuese dhe e kufizon konkurrencën për arsye se licenaca është e nevojshme për OE që merren me prerje dhe transport të drunjëve për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore dhe një licencë të tillë nuk e kanë OE që merren me blerjen dhe rishitjen e drunjeve, por jo me prerjen e tyre në pyje. Kjo Licencë nuk lëshohet Agjencia e Pylltarisë së Kosovës por nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Kerkesa 4. Lot 1- Operatori ekonomik per realizimin e ketij projekti duhet te kete asete te mjaftueshme konform kerkesave te AK

a) *Kontrat nga Agjensioni i pyjeve ose - dëshmia a)kontrate nga agjensioni i pyjeve me leje per prerje dhe transpot te druve ose*
b) *Mal ne pronsi individuale ose - b)Ngastra duhet te posedoj leje per prerje dhe transport te druve nga Agjensioni i pyjeve ose*
c) *Mal te bler nga personi fizik - c)Ngastra e blere duhet te posedoj leje per prerje dhe transport nga agjensioni i pyjeve*

OE "BERVENIKU CORPORATION" SH.P.K ka depo për grumbullimin e drunjeve të cilat janë blerë të gatshëm dhe të cilat janë të mjaftueshme për ta realizuar furnizimin e Komunës së Gjilanit, prandaj kërkesa 4, sic është përcaktuar në dosjen e tenderit ja pamundëson OE "BERVENIKU CORPORATION" SH.P.K të dorëzojë ofertë për furnizimin me dru në K.Gjilanit.

Kerkesa 5. Lot 1-Operatori ekonomik duhet të ketë puntor-teknik staf te mjaftueshmes per realizimin e ketij procekti Operatorit Ekonomik dhe atë për minimum (12) punëtorë-teknik . Dëshmia 5. Lot 2 -Listë e puntorëve - teknik e cila duhet të jetë e nënshkruara dhe e vulosur, për të gjithë puntorët duhet dëshmuar listen e puntorve te nxjerr nga ATK , PER TRI VITET E FUNDIT (2021,2022,2023).

Kerkesa 6. Lot 2-Operatori ekonomik duhet të ketë puntor-teknik staf te mjaftueshmes per realizimin e ketij procekti Operatorit Ekonomik dhe atë për minimum (5) punëtorë-teknik.
Dëshmia 6. Lot 2- Listë e puntorëve - teknik e cila duhet të jetë e nënshkruara dhe e vulosur, për të gjithë puntorët duhet dëshmuar listen e puntorve te nxjerr nga ATK , PER TRI VITET E FUNDIT (2021,2022,2023)

Kërkesa 5 dhe 6 nuk është relevante për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet" dhe është diskriminuese për arsye se për realizimin e furnizimit me dru, nuk është e nevojshme dhe as relevante që stafi të këtë kualifikime teknike për shkarkimin e drunjëve në shkolla. Stafi Teknik është I nevojshëm për përpunimin e drurit dhe si e tillë kjo kërkesë është diskriminuese dhe kërkojmë të hiqet nga dosja e tenderit?

Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Dëshmia 5 OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj listën e pasjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim të vërtetuar (vërtetim nënshkrimi) noterizuar në mes qiradhënsit dhe qiramarrësit me prezence të dy palëve. Per paisjen (mjete punes) motor dore kerkohet fatur e blerjes
Kamion me kran min 12 ton
Kamion me kran nen 7 ton
Kamion nen 7 ton
Traktor tereni me mekanizem terheqes (sajlle)

Vërejtje
Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet.

Sqarime për kërkesën 5 – Aneksi 7 I DT – Për informatat që ne i kemi në treg nuk ka kamion me kran min 12 ton dhe as kamion me kran nen 7 ton, ju lutem të na siguroni informata sqaruese për këto dy lloje të kamioneve?

Sqarime na nevoiten edhe për kaminon nën 7 ton, cfarë lloji dhe me cfarë mekanizmi operon ky kamion?
Po ashtu keni kërkuar "Traktor tereni me mekanizem terheqes (sajlle), 2 copë", ky lloj I traktorit është I përdorshëm vetëm për terene malore. Cila është arsyeja që është kërkuar nga OE të kenë tractor të këtij lloji, kur dihet se të gjitha shkollat kanë terren që furnizimi mund të bëhet me kamion?

E paqartë është edhe vërejtja se "Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet", për më tepër cfarë është pretenduar nga AK lidhur me verifikimin e pajisjeve të ofruara?
Vërejtje
Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet.

Kërkesa 5 në të cilën janë përcaktuar mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit, është jo propercionale më lëndën e kontratës sepse sipas ***informatave që ne i kemi në treg nuk ka kamion me kran min 12 ton dhe as kamion me kran nen 7 ton, si dhe për kaminon nën 7 ton nuk është përcaktuar mekanizmi me të cilin operon ky kamion. Po ashtu janë kërkuar*** **"Traktor tereni me mekanizem terheqes (sajlle), 2 copë", që nuk janë të nëvojshem për realizimin e aktiviteti të prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet" për arsye se të gjitha shkollat kanë terren që furnizimi mund të bëhet me kamion, Përvec kësaj Kamionet kanë kapacitet më të madhe për barje të sasiave me të mëdha të drunjeve sesa traktorët..**
E paqartë është edhe vërejtja se "Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet", për më tepër pretendimi i AK se për kufizim të konkurrencës lidhur me verifikimin e pajisjeve të ofruara?

Të gjitha këto kritere të përzgjedhjes janë të vendosura në kundërshtim me qëllimin e prokurimit publik, ekonomiciteti dhe efikasitetin, e kufizojnë konkurrencën dhe janë favorizuese për një OE që K.K. Gjilan ka menduar ta shpërblej me kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë që të nxjerrët:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **"BERVENIKU CORPORATION" SH.P.K**

LARGOHEN nga dosja e tenderit të gjitha këto kritere jorelevante, joproporcionale dhe diskriminuese dhe që e kufizojnë konkurrencën, si dhe kriteret e përzgjedhjës të përcaktohen sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform lëndës së aktivitetit të prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet".

Nëse edhe kërkesa për rishqyrtim nuk trajtohet sipas kërkesave të LPP , **"BERVENIKU CORPORATION" SH.P.K** do t'i drejtohet OSHP-së me ankesë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik **"BERVENIKU CORPORATION" SH.P.K** është taksapagues i rregullt i taksave dhe tatimeve të vendosura me ligjet dhe aktet tjera nën ligjore të

Republikës së Kosovës, që janë pjesë e të hyrave shtetrore dhe se një diskriminim dhe trajtim jo i bartabart nga ana e autoriteteve komunale e dëmton dhe pamundëson materialisht zhvillimin dhe funksionimin e veprimtarisë së tyre.

Eleminimi nga konkurrenca pa arsye dhe duke mos i zbatuar kërkesat e LPP dhe legjislacionit sekondar, i sjell OE **"BERVENIKU CORPORATION" SH.P.K** dëmet materiale si në vijim:

- Kosto e përgaditjes së ofertës - OE ka paguar paraprakisht qira për sigurimin e kamioneve;
- Humbja e mundësisë për të fituar kontratën, OE kishte planifikuar të fitonte kontraten, dhe nuk arrinë të shpërblehet, OE e humb mundësin tejet të rëndësishme për të siguruar/fitur një kontrat të re;
- Dyshime mbi zbatimin e parimeve të prokurimit publik dhe kornizes ligjore në fuqi;
- Pengesa për tenderime tjera, mos shperblimi me kontratë mund te shkaktoj pengesa perkohesisht ose te perhershem nga të tjera tenderime të organizatave të ngjajshme. Etj

Keto janë vetem disa nga dëmet potenciale që i shkaktohen OE **"BERVENIKU CORPORATION" SH.P.K** nga mos shpërblimi me kontratë duke qenë i përgjegjshme dhe me cmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për dhënien e kontratës. Është obligim ligjor i AK Spitali i Pejës që gjatë përdorimit të parasë publike përmes procedurave të tenderimit, të veproj në përputhje të plotë më LPP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*